

**AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“KK ENERGY”shpk**

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i Shoqërisë;

**Kreu I
Themelimi, Zoterimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Ortakët Themelues**

1.1 Sot, më 26.07.2023 themeluesit, kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “KK ENERGY” shpk.

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

- Petrit Lushakaj, lindur në Vjosë, Shqipëri, më 20.05.1972, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.ID H20520025R.
- Rudolf Kuçi, lindur në Fier, Shqipëri, më 31.03.1999, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.ID J90331056M.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Prodhimi, transmetimi, shperndarja dhe shitja e energjisë. Zhvillim te projekteve ne sektorin e energjive të rinovueshme, ndertimin dhe mirembajtje te punimeve civile, objekteve te ndryshme, linjave elektrike, kerkim dhe zhvillim te shpellave dhe minierave. Import- eksporti, tregimi me shumice dhe pakice i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave qe lidhen me kryerjen e aktivitetit ne fushen e energjisë. Prodhimi i gazit; shperndarja e lendeve te gazta nepermjet tubacioneve. Projektimi, ndertimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve per prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kerkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave per prodhimin e energjisë. Asistenza teknike, riparime dhe mirembajtja e aparaturave per prodhimin e energjisë. Instalimi dhe ndertimi i impianteve energjitike nga burime te rinovueshme nga dielli, era, uji, etj. Prodhimi, transmetimi, shperndarja dhe shitja e energjisë nga burime te rinovueshme. Importi dhe eksporti i mallrave e pasjisjeve te teknologjise ne fushen e energjitetikës, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaikë e forma te tjera te prodhimit te energjisë te ushqyera nga burime te ndryshme dhe nga ato te caktuara si : hidroelektrike, diellore, me ere, biomasa etj. Mirembajtja e centraleve energjitike.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

**Neni 4
Selia**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën “Ruga Fier- Seman, Fshati Afrim i Ri, njësia Qender, afër Karburant Kuçi, Fier”.

4.2 Asambleja e ortakëve mund të hapi ose të mbylli adresa dytësore, filiale, zyra përfaqësimi ose degë, zyra në Shqipëri ose jashtë.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë.

5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- Rudolf Kuçi titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë që përbën 70% të kapitalit të shoqërisë.
- Petrit Lushakaj titullar i 1(një) kuotë me vlerë prej 30.000 (tridhjetë mijë) lekë që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e përgjithshme e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur kontributin e tij ne kapitalin themeltar të shoqërisë.

6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila vendos në të njëjtat kushte që kërkohen për modifikimin e statutit.

6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi prek kapitalin e ortakëve në të njëjtën masë të pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre janë lirisht të transferueshmë si në rastet më poshtë:

- në rastin e ortakut person fizik, përfektivisht të trashëgimisë në rast vdekje apo nëse transferohen te bashkëshorti apo pasardhësve të ortakut;
- në rastin e ortakut person juridik nëse transferimi bëhet te ortakët e shoqërive pjesmarrëse (filialët) apo të lidhura me ortakun person juridik. Ky rast parashikon edhe mundësinë e operacioneve të mundshme të transformimit, bashkimit apo ndarjes apo blerjeve së shoqërive.

7.2 Në të gjitha rastet e tjera të transferimit të kuotave, i përket ortakëve e drejta e zgjedhjes dhe e preferencës.

7.3 Në çdo rast transferimi i kuotave të kapitalit nga ortaku duhet të bëhet me akt notarial.

KREU III

Organet e Shoqërisë

Neni 8

Organi Vendimmarrës

8.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

8.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim te statutit

sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për cështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shperblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) ekzaminimin e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë të përgatitur nga administratorët;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) cështje të tjëra të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të vaprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Neni 9

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

9.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga Ligji, nga Statuti dhe cdo herë që asambleja bëhet e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

9.2 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresën që rezulton nga Libri i Ortakëve ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike e certifikuar që u dërgohet të gjithe ortakëve. Njoftimi dërgohet të paktën 7(shtatë) ditë përrpara datës së parashikuar per mbledhjen e Asamblesë.

9.3 Njoftimi duhet të përbajë informacion mbi tipin e asamblesë, vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës për thirrjen e parë dhe thirrjen e dytë. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

9.4 Asambleja do të thirret dhe do të mbahet rregullisht edhe kur nuk janë respektuar formalitetet e njoftimit të saj, në momentin kur, janë prezent ortakët, të cilët përfaqësojnë kapitalin e plotë social.

9.5 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamble edhe nëpërmjet telekonferencë ose nëpërmjet përdorimit të mjeteve të tjera elektronike me kusht që të jenë të identifikuar të gjithë pjesëmarrësit dhe të jetë e mundur që të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë drejtëpërsëdrejti në trajtimin e rendit të ditës si dhe të kenë mundësi të shqyrtojnë apo të marrin dokumentacionin dhe ta transmetojnë atë dhe në fund te marrin rregullisht pjesë në votim dhe në vendimarrje.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Në rastin e marijes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund

të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë shumicën e kuotave të kapitalit.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për cështje që kanë të bëjnë me modifikimin e statutit, veprime që sjellin ndryshimin thelbësor te objektit të aktivitetit ose një ndryshim të rëndësishem të të drejtave të ortakeve, emërimin e likuiduesve dhe kriteret e kryerjes së likujdimit, operacionet e transformimit, bashkimit apo ndarjes, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent personalisht ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e votave.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kuotave të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për cështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin edhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

11.3 Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB) për të pasqyruar ndryshimet në ekstraktin e shoqërisë.

Neni 12 Administrimi

12.1 Administratorët kanë të drejtat dhe kompetencat për administrimin e përgjithshem dhe të vecantë të Shoqërisë brenda limiteve që vendos Ligji, ky Statut dhe kompetencat qe i përkasin asamblesë së ortakëve.

12.2 Administratori i Shoqërisë është: Rudolf Kuçi, lindur në Fier, Shqipëri, më 31.03.1999, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.ID J90331056M, i cili emërohet për një periudhë 5(pesë) vjecare;

Nënshkrimi i administratorit:

Rudolf Kuçi


Neni 13 Kompetencat e Administratorëve

Detyrimet e administratorëve:

- a) Të kyejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdesen për mirëmbajtjen korrekte të dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërise;

- d) Të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojnë një sistem kontrolli mbi rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Rëgjistrimit;
- g) Të raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Të marr vendime të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e adresës/save te shoqërisë, duke përfshirë këtu dhe selinë qëndrore;

Neni 14 **Përgjegjësitë e Administratorit**

14.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje te kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

14.2 Dëmet e shoqërisë qe rrjedhin nga marrëveshjet të cilat nuk janë të miratuara nga asambleja i ngarkohen administratorit i cili ka bërë marrëveshjen;

14.3 Me përjashtim të rasteve të parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit te besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmëndje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vleresojë me përgjegjësi cështjet, për të cilat merret vëndim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshem, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Kreu IV **Viti finanziar**

Neni 15 **Viti Financiar dhe bilanci vjetor**

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylltet më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 16 **Raporti vjetor**

16.1 Organi administrativ ose, sipas rastit, eksperti kontabël paraqet raportin finanziar vjetor brenda 3(tre) muajve të vitit ushtrimor pasardhës.

16.2 Raporti përmban informacione mbi shpenzimet, të ardhurat dhe çdo lloj informacioni finanziar tjetër mbi shoqërinë.

16.3 Asambleja miraton bilancin dhe llogaritë financiare të ushtrimit brenda 6 muajve të pare në vitin ushtrimor pasardhës.

Kreu V
Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Neni 17
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

Neni 18
Riorganizmi i shoqërisë

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 19
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe cili do ligj tjeter qe aplikohet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Mosmarrëveshjet


Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe palës së tretë, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21
Kopjet

Ky Dokument u redaktua në 1(nje) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Lexuar, miratuar, konfirmuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Rudolf Kuçi Rudolf Kuçi


Petrit Lushakaj Petrit Lushakaj
